



Datës-izlaze

Nr. -1-212

Data 17.12.2019

Br.

Datum

OBILIÇ-OBILIÇ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Qeveria - Vlada - Government

Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

Në mbështetje të nenit 53, të Ligjit nr. 03 / L-040, nenit 62 të Statutit të Komunës, thërras:  
Mbledhjen e Komitetit për Komunitete për dt. 23.12.2019, ( e hënë) nga ora 10:00 me këtë:

## REN DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Planit vjetor të punës të Komitetit për komunitete për vitin 2020
4. Të ndryshme



Kryesuesi i Komitetit për Komunitete

*(Signature)*  
Avdyl Mustafa



Dalës-Izlazna

Nr. 1-213  
Br.

Data 17.12.2019  
Datum

OBILIĆ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për komunitete, të mbajtur me dt.13.11.2019 në ora 10 në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Arbnore Nasufi, Lulzim Sadiku, Nazmi Gashi, Avdyl Mustafa, Haki Abazi, Katarina Adjancic, Enisa Boshnjak, Faton Beka dhe Bobana Dancetovic .

**Të pranishmit tjerë:** Slavisa Adjancic, shef i ZKKK-së, Arben Berisha, drejtor i DMM-së dhe përf.OSBE.

Mbledhjen e udhëhoqi Avdyl Mustafa, kryesues i Komitetit për komunitete, i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

### REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Informatë nga Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm, Kadastër dhe Pronë lidhur me legalizimin e objekteve pa leje ndërtimore
4. Informatë nga Zyra komunale për komunitete dhe kthim lidhur me procesin e kthimit
5. Të ndryshme

**Kryesuesi** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

#### **1. Pika e parë e rendit të ditës**

**Të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e Komitetit.**

#### **2. Pika e dytë e rendit të ditës**

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

#### **3. Pika e tretë e rendit të ditës**

**Avdyl Mustafa** – Për një sqarim më të gjerë rreth legalizimit të objekteve pa leje ndërtimore fjalën ia dha drejtorit të DPUKP-së.

**Arben Berisha** – Ne e kemi Ligjin nr.06/L-024, për trajtimin e ndërtimeve pa leje dhe jemi një ndër Drejtoritë e para, që e kemi bërë një plan se si do të rrjedhë situata dhe si do të shkoj çështja e legalizimit. Ne kemi punuar në këtë drejtim si Drejtori, por çështja buxhetore neve na mbetet peng për realizimin e ekipit për trajtimin e ndërtimeve pa leje. Unë kam shkue deri në numrin 5 të grupeve, por nëse nuk kemi buxhet duhet me reduktue në 3 grupe dhe çdo grup do ta ketë 1 gjeodet, 1 arkitekt, 1 ndërtimtar, 1 jurist dhe 1 ekonomistë. Këto grupe do të jenë të organizuara sepse duhet të vizitohet çdo shtëpi, që është një proces jo i lehtë dhe do të ketë shumë punë. Procesi i legalizimit do të zgjatë 3 vite dhe sipas ligjit Ministria dhe Komuna ka përgjegjësi. Komuna ka përgjegjësi që rastet sociale dhe organizatat e dalura nga lufta të gjitha janë pa pagesë. Mirëpo, edhe të tjerët që aplikojnë, 1 euro është m<sup>2</sup> por Kuvendi komunal ka të drejtë me ulë këtë tarifë në 50 centë, ose me bë pa pagesë.

**Faton Beka** – Pyeti se kur fillon legalizimi i këtyre pronave dhe a do të thotë se është anulue, apo ka rënë poshtë krejtë forma e legalizimit pa pagesë, që ka qenë më heret para 10 viteve. Pyetja tjetër është cilat objekte do të legalizohen, vetëm shtëpitë, apo edhe objektet tjera, që janë afër shtëpive si shtallë, shupë etj.

**Nazmi Gashi** – Ky është proces që e njohë sepse kam qenë në procedurë dhe Komuna jonë është një ndër Komunitatet më të interesuara për legalizimin e objekteve. Mendoj se probleme dhe paqartësi do të ketë, por nëse zyrtarët që përcaktohen me krye këtë detyrë punojnë me një logjikë të shëndoshë, besoj se mund ta kemi një rezultat të kapshëm në krahasim me Komunitatet tjera, të cilat kanë probleme më të mëdha. Poashtu, mendoj se fajin e kemi ne sepse 20 vjet, kemi uzurpue, kemi shkatërrue dhe nuk kemi respektue kurgjë në oborrin tonë së pari, pastaj edhe në hapësirën publike. Unë gjithmonë jam i gatshëm me ndihmue dhe këshillue për aq sa di.

**Avdyl Mustafa** – Unë pajtohem plotësisht me z.Nazmi Gashi, dhe si kryesues i këtij Komiteti mund të them se nëse, ju duhet ndihma ime ne jemi këtu për të punuar së bashku.

**Arben Berisha** – Përgjegjet se jemi Komuna më e veçantë me problemet më të mëdha të legalizimit sepse problemet më të mëdha ne si Komunitat i kemi në nivel të Kosovës. E kemi nenin 6, pika 1.10, që thotë: "Identifikimi dhe përfshirja në listë të pritjes të gjitha ndërtimet pa leje" që do të thotë se të gjithë ata që kanë probleme, do të jenë në listë të pritjes. Tash, unë nuk e di se çka do të bëhet me listë të pritjes sepse Kryeministri i ardhshëm do të marrë një vendim se qysh do të mbetet kjo çështje. Nëse, parcela ku është ndërtuar shtëpia është pronë komunale, atij nuk i refuzohet, por mbetet në listë të pritjes, që në të ardhmen Kryeministri mund të thotë për të gjithë ata që janë në listë të pritjes, ju jepet e drejta me ua bartë në emrin e tyre. Në pronat shoqërore, në tokat bujqësore, në komosacion, sipërfaqe të mbrojtura, zona të mbrojtura, zonat e veçanta të mbrojtura, që Obiliqi komplet këto i ka dhe të gjitha këto do të shkojnë në listë të pritjes. Sa i përket legalizimit të objekteve, legalizohen kategoria e parë dhe e dytë, pastaj e treta është Kosova B, me interes nacional. Legalizimi ka fillue në shtator 2018, janë fotot që janë bërë që duket gjithçka dhe përmes gjeoportalit e shohim se është nisë shtëpia dhe ajo mund të legalizohet, nëse mëtutje nuk është në orto foto, atëherë ajo nuk mundet me u legalizue.

**Nazmi Gashi** – Lista e pritjes për prona jo të sqaruara, që janë në pronat komunale nëse, nuk janë interes i drejtëpërdrejtë shtetëror ligji për hapësirat publike e ka sqaruar mirë, që është e drejtë e Kryetarit përmes Kuvendit. Është mirë me shfrytëzue këtë sepse drejtorit i ndihmon shumë dhe qytetarit.

**Arben Berisha** – Ne kemi probleme sepse pronën e Kuvendit komunal nuk mundesh me tjetërsue në formën që me ia dhënë dikujt dhe u krye, kjo nuk lejohet. Ne e kemi Obiliqin dikund rreth 30 %, që shtëpia është e personit të caktuar por parcela e KEK-ut dhe kjo ka me qenë njëra prej atyre listave të pritjes, që Kryeministri do të marrë vendim për bartje të asaj pjese. Poashtu është Dardhishta, në anën e hirit komplet është pasuri e Kuvendit komunal dhe në këtë kontekst ne do të kemi problem, që këto do të dalin në listë të pritjes. Një gjë duhet ta dijmë se nëse, prona është e shtetit delë në listë të pritjes, por nëse ka konflikt lidhur me pronën në mes njerëzve, atëherë çështjen e zgjidhë Gjykata.

**Faton Beka** – Pyeti zonat me interes të veçantë a do të hyjnë në listë të pritjes, nëse janë ndërtue pas vitit 2018.

**Arben Berisha** – Përgjegjet lista e pritjes do të jetë së pari identifikimi i pronës ku është psh ura e Palajve, deri në përfundim atje te Grabofci, komplet është zonë me interes të veçantë dhe kjo komplet do të delë në listë të pritjes. Është një vendim i Kryeministrit që nga viti 2004, i ripërtirë në vitin 2009, që ende është në fuqi, por me plan zhvillimor kam me provu në bazë të zhvillimeve të KEK-ut dhe nga KEK-u, e kam marrë një projekt se deri në 40 vite nga shtrihet KEK-u dhe ne të parashohim se deri në 40 vite, me pasë të drejtë me dhënë leje në ato zona, ku KEK-u nuk prekë.

**Muharrem Haziri**, përf.i OSBE-së - Prej disa analizave në terren që kemi pasë, kur ishte më heret procesi i legalizimit, problemi kryesor i qytetarëve ishte përgatitja e dokumentacionit, që atyre iu ka kushtue më shumë se sa tarifa që kanë pasë me pague për legalizim. Unë pyes si qëndron tani kjo çështje.

**Arben Berisha** – Përgjegjet se ligji tash e ka lehtësue shumë dhe më heret është dashur me i bë matjet, me marrë përsipër barrën dikush se a është konfiguracioni në rregullë, sa ka hekur, sa ka beton, që asnjë person

nuk e merrë barrën e objektit që me thënë se ky objekt e ka qëndrueshmërinë në rregullë. Ne më shumë kemi të bëjmë me objekte të vjetra dhe me lloj lloj ndërtimesh, që barrën tash e merrë vet pronari. Ne jemi duke e përgatitë informimin për qytetarë dhe ata që nuk aplikojnë, atyre do të iu lëshohet leja e rrënit.

**Arbnore Nasufi** – Pyeti për zonën përballë Kosovës B, te elektrobartja a hyn ajo zonë në atë 40 vjeçar in që mundet me u ndërtue, apo jo sepse unë e di se është ndalue një rast aty dhe dua të di se a lejohet të ndërtohet apo nuk lejohet.

**Arben Berisha** – Përgjegjet se më vjen shumë keq që atij njeriu nuk kemi mund me i ndihmue pavarësisht që ai me investime vetanake ka fillue ndërtimin dhe iu ka bërë rrënim, që ndoshta është e padrejtë. Mirëpo, ligji i ndërtimit nuk lejon ndërtimin në afërsi të Kosovës B, ose Kosovës A, në afërsi deri në 1,000 metra largësi, në raste të veçanta lejohet deri në 500 metra.

**Arbnore Nasufi** – Ka pasur raste që aty është ndërtue.

**Arben Berisha** – Përgjegjet e di, por unë po flas për Drejtorinë e urbanizmit, e jo të inspeksionit. Unë ju lus, që ju si anëtarë të Kuvendit komunal ta jepni kontributin te çështja e planit zhvillimor komunal sepse mu nga kjo varet se për 10 vjet, si ka me u ndërtue, çka ka me u ndërtue dhe ku ka me u dhënë leja..

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Slavisa Adjancic** – Sa i përket Zyres në bazë të Rregullores së Qeverisë së Kosovës nr.01/2018 për kthim dhe reintegrim, ne punojmë sipas kësaj Rregulloreje sikurse edhe të gjitha institucionet tjera, të ngjashme në Kosovë. Në Kuvendin Komunal është diskutuar rreth problemit të ndërtimeve për të kthyerit, ku është parashtruar edhe një peticion qysh në vitin 2014 i qytetarëve të të gjitha nacionaliteteve të Plemetit, ku është kërkuar që të mos u ndërtohen shtëpi familjeve, që kthehen nga Komunitat tjera. Megjithatë kjo është shkelje e ligjit, sepse ligji thotë se familjet mund të kthehen aty ku ndihen më të lirshme dhe aty ku mund ta ndërtojnë të ardhmen e tyre. Familja vetëm duhet ta posedojë pronën në emrin e vet dhe automatikisht e fiton statusin e qytetarit-banorit të Komunës. Ne kemi bërë transferimin e 6 shtëpive në vitin 2019, dmth të shtëpive ë nuk janë ndërtuar në vitin 2018.

Sa i përket programit që duhet të kryhet rreth ndërtimit për vitin 2019, tash për tash po ndërtojmë 14 shtëpi dhe shumica prej tyre rreth 55 %, janë përfunduar dhe shpresojmë që në këto 7 ditë t'i përfundojmë. Një shtëpi është përfunduar më heret në Plemetin, derisa një shtëpi e Sami Krasniqit në Obiliq, si duket do të bartet për ndërtim në vitin 2020, sepse pronari duhet të jetë i pranishëm gjatë ndërtimit të shtëpisë, e po ashtu edhe 11 shtëpi të tjera, do të barten në vitin 2020. Në Zyren tonë kemi 303 kërkesa për kthim në bazë të Rregullores dhe ligjit dhe sipas të gjitha gjasave disa familje, nuk do të përfshihen në këtë program nese nuk i plotësojnë kriteret, apo nuk posedojnë pronë. Ju e dini se më heret kanë jetuar disa familje tek Elektrobartja, disa familje rromë në Obiliq, disa të tjera në Subotiq dhe në Caravodicë dhe të gjitha shtëpitë e tyre kanë qenë të ndërtuara në pronën komunale. Ne do të bisedojmë me ata në ndonjë mbledhje dhe do ta shqyrtojmë çështjen në Kuvend se si të gjejmë një mënyrë tjetër që këta ta vërtetojnë se kanë jetuar në Obiliq deri në vitin 1999, pasi që prona e tyre evidentohet në emër të Komunës, KEK-ut, apo dikujt tjetër. Prej të gjitha këtyre kërkesave prej 303, 29 kërkesa i kemi nga familjet që përkohësisht jetojnë në Maqedoni, 9 në Mal të Zi dhe 29 në Serbi, që janë vizituar. Ju e dini se 75 familje, që janë kthyer nga Maqedonia dhe shumica prej tyre kanë blerë pronë në Plemetin, neve na mbetet që ta kryejmë procesin e ndërtimit ashu siç e thotë ligji. Pra, i kemi vizituar 8 familje ne Plemetin, ku po jetojnë dhe kanë pronën e tyre të kthyer nga UNHCR-ja, në vitin 2017 dhe kemi edhe 10 familje në Graçanicë, në Ferizaj 11 familje, në Gjilan 2 familje dhe në Fushë Kosovë një familje.

**Nazmi Gashi** – Ka 2 vite, që po të lus për rastin e Artonit, i cili nënën e ka hungareze dhe është me vëlla, por njëri flen verës 1 javë në ahër, e tjetri hyn në shtëpi. Mirëpo, kur bëhen rrobat pa pastru ky tjetri delë në ahër, ndërsa ai shkon në shtëpi. Askush nuk e merrë si shqiptarë sepse është i përzier, ashkali nuk është, rom nuk është, sërbë nuk është dhe vetëm kur dikujt i vyejnë votat shkojnë dhe e vizitojnë atë familje. Unë qe 2 vite e luti, me u marrë me këtë problem, eja në Sibofc dhe shikoje vetë. Unë e di se ka probleme shumë, por



duhet me u marrë edhe me rastet tona, e jo me kërkue prej Gjilanit e Prizrenit sepse ai ku ka jetue qe 20 vjet, jeton edhe 2 vjet. Ju duhet të na ndihmoni edhe ne të kordinohemi dhe me gjetë zgjidhje të përbashkëta.

**Slavisa Adjancic** – Deri në vitin 2018, derisa nuk u nxorrë Rregullorja e re edhe pse atëherë kemi kërkuar një balancim dhe se e dimë se edhe nga komuniteti shqiptar ka mjaft prej tyre që jetojnë në kushte të vështira. Fatkeqësisht nuk na kanë lejuar as donatorët, as Ministria për kthim, që t'u ndërtojmë shtëpi këtyre familjeve. Megjithatë, një shtëpi veç është në proces të ndërtimit në Plemetin për Agron Halitin, ndërsa tash ligji parasheh që të gjithëve mund t'u ndërtohen shtëpitë për kthim dhe zgjidhje të përhershme sipas nenit 3.1.4. për personat e zhvendosur prej dt.28 shkurt 1998 deri me 31 mars 2004.

**Lulzim Sadiku** – Dua ta bëjë një pyetje konkrete sepse një grup i nacionalitetit shqiptar nga fshati Plemetin, ka bërë një kërkesë se me dt.16 është një debat bukur i gjerë për çështjen e Plemetit. Ata janë të shqetësuar për faktin se në Plemetin vijnë shtresa të ndryshme të njerëzve që nuk kanë qenë banorë të fshatit Plemetin, do të thotë se në fshatin Plemetin të gjitha pakicat njihen në mes veti më shumë se 60 vite, që e kanë moshën. Tash, aty vijnë njerëz që nuk kanë banuar fare dhe nuk kanë asgjë në Plemetin. Ata e kanë gjetë si vendbanim këtë fshat dhe unë kisha dashur të dijë çështjen e shqetësimit të këtyre banorëve, që e kanë thirrë këtë takim.

**Slavisa Adjancic** – E theksova që Qeveria e Kosovës e ka hartuar Rregulloren dhe ligjin, nuk ka hartuar as Plemetini, e as Obiliqi. Ligji është nxjerrë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Plemetinasit janë fajtor vetë, sepse po shesin pronën, dhe nuk po ju kuptoj që po bëni pyetje të tilla, të ulëta. Kjo është njësoj sikur të blej një apartament në Beograd ose kudo tjetër, dhe normalisht po rrezikoj situatën, sepse popullsia po rritet menjëherë. Nëse është në përputhje me ligjin dhe Rregulloren, nëse ju Kuvendi nuk respektoni vendimet e ligjit e Qeverisë, ju merrni një vendim në Kuvend. Kush do t'i ndalojë ata të bëjnë shtëpi nëse bëjnë me shpenzimet veta, askush nuk do t'i ndalojë ata. E di problemin që ka qenë në Kuvend, prandaj po pres që ju të merrni një vendim. Unë them në bazë të ligjit, sepse nuk mund të marrë disa vendime të pavarura, por tani ka pasur ndryshime në ligj, ndryshime në Rregullore.

**Lulzim Sadiku** – Unë të dëgjova, në fakt që tregon tregime dhe përralla, vërtetë je i mirë të tregosh përralla, të tregosh për ligjet e Republikës së Kosovës. Mos harro, se unë jam nga ata që shpejt do ta marrë titullin doktor shkence. Qëllimi i kësaj që të pyeta dhe të kam pyet edhe më heret është se në fshatin Plemetin nga minoritetet kanë ardhë 270-280 familje, sipas të dhënave që jepen nga statistikat e partive politike. Asnjëherë nuk kam pyet për ata që blejnë prona në Amerikë, Afrikë, që është e drejtë e tyre ligjore. Unë kam kërkuar që njerëzit të mos grumbullohen dhe të jetojnë në gjendje mizore. Poashtu, kam kërkuar nga Kuvendi komunal të vëhen kushte, rregulla, të mos vijnë njerëzit si banorë dhe të strehohen pa asnjë kusht jetese. Ata që e kanë thirrë takimin kanë shqetësimet e tyre dhe asnjëherë nuk na ke dhënë një statistikë të saktë se sa banorë të ri kanë ardhë. Unë prapë do të kërkoj që rasti të bisedohet në takimin me dt.16, ndërsa sa i përket ligjeve të Republikës së Kosovës, unë i njohë dhe i di shumë mirë. Nëse, të gjitha këto familje paskan ble në Plemetin, qenka problem se nuk paska mbetë asnjë tokë e diku tjetër. Ne jemi këtu, që të bashkëpunojmë që njerëzit të jetojnë në kushte të mira, të bisedojmë me nivelin qëndror, lokal, me fshatin Plemetin dhe të iu gjejmë zgjidhje atyre që vijnë dhe jetojnë aty. Ne e kemi edhe kampin e Plemetit, që e dijmë se në në çfarë kushte jetojnë, por qëllimi i asaj që kam thënë është se urbanizmi, shëndetësia, Arsimi, të ofrojnë për ata njerëz që janë banorë të Plemetit, apo kanë ble parcelë në Plemetin kushte të domosdoshme. Nëse, e shikojmë komunitetin pakicë aty, ka që jetojnë në kushte të skajshme.

**Slavisa Adjancic** – Unë mendoj se ne po themi të njëjtën gjë, kështu që ato familje që erdhën dhe janë vendosur aktualisht në ndonjë pronë private, ose kontejnerë, ne jemi duke punuar për të zvogëluar këto probleme. Mund të them që pranë fushës së futbollit ka 2 kontejnerë në Plemetin. Ne i vizitojme ato çdo ditë si Idriz Makollin dhe Aziz Makollin, një organizatë muslimane ua ka blerë parcelat, për fat të keq ne bëmë një kërkesë për t'u ndërtuar nga një shtëpi për të ulur këtë problem dhe ta mbyllim këtë kamp. Ne i bëmë një kërkesë kadastrit, por kadastrit refuzoi kërkesën tonë. Më e rëndësishmja, është se Kryetari i Komunës po bën përpjekje për mbylljen e barakave. Pra, ne kemi ndërtuar tashmë një shtëpi atje, 2 janë në proces dhe ne

do të zvogëlojmë atë numër. Secili projekt ka qëllimin e vet për të ndërtuar infrastrukturën, për shembull, tani kemi ndërtuar 9-12 shtëpi në Plemetin, dhe ne po ndërtojmë një rrugë që lidhet me rrugën tjetër. Ne ju kemi ndërtuar kanalizimin, e shumë projekte infrastrukture. Unë nuk shohë familje në gjendje kaq të keqe, përveç atyre që jetojnë në baraka.

**Avdyl Mustafa** – Një gjë më duhet ta them se ne përfaqësuesit e komuniteteve pandërprerë jemi në kontakt me ta dhe do të punojmë edhe më tej për të gjetur zgjidhje për problemet të cilat i hasim në terren.

**Pika 5 e rendit të ditës**

**Avdyl Mustafa** – Tani, e lus, z.Nazmi Gashi, të na tregoj se kur mund të shkojmë në trajnim.

**Nazmi Gashi** – Ju njoftoj se kryesuesi kërkesën e ka aprovue dhe ne si Kuvend komunal me dt.22, do të shkojmë në një trajnim pune. Pasi, ta kryejmë këtë trajnim besoj se pas dt.25, ne si Komitet mund të shkojmë në trajnim.

**Mbledhja përfundoi në ora 11:33'**

**Procesmbajtëse**



Azize Zeneli



**Kryesuesi i Komitetit**

**Avdyl Mustafa**